



Republika e Kosovës – Republika Kosova  
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia  
Izhorni Panel zu Žalbe i Predstavke

Anr.571/2021

**Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia (PZAP)**, në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Adnan Konushevcu kryesues dhe Faton Ademi dhe Rustem Thaqi anëtarë, duke vendosur lidhur me apelin e parashtruar nga Isuf Qestaj me vendbanim në Gjermani, paraqitur kundër Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ), lidhur me mos përfshirjen në listën përfundimtare të votuesve jashtë Kosovës, për Zgjedhjet Lokale në Republikën e Kosovës që do të mbahen me datën 17 tetor 2021, në seancën e panelit të mbajtur me datë 02.09.2021, mori këtë:

#### V E N D I M

**Pranohet** i bazuar apeli i ushtruar nga Isuf Qestaj me vendbanim në Gjermani, i paraqitur kunder KQZ-së, për shkak të mos përfshirjes në Listën Përfundimtare të Votuesve Jashtë Vendit për Zgjedhjet Lokale në Republikën e Kosovës, që do të mbahen me datën 17 tetor 2021, **Urdhërohet** KQZ-ja, të përfshijë apeluesin në Listën e Votuesve Jashtë Kosovës.

#### A r s y e t i m

Me datën 31.08.2021 PZAP-i, ka pranuar një apel nga Isuf Qestaj me vendbanim në Gjermani, në të cilën pretendohet se ka aplikuar me email adresën e tij për të gjithë familjarët për regjistrim si votues jashtë Kosove, dhe se Komisioni Qendror i Zgjedhjeve ia ka refuzuar aplikimin të gjithë familjarëve me arsyetimin se nuk ka qenë adresa adekuate për aplikim, për tu përfshirë në listë si votuese jashtë Kosovës për Zgjedhjet Lokale, që do të mbahen më 17 Tetor 2021.

Më tej thekson se edhe pse i njëjti i ka plotësuar kriteret për tu përfshirë në listën e votuesve jashtë Kosove, emri i tij nuk gjendet në listën e KQZ-së

Parashtruesi i apelit ka bashkangjitur imazh të dokumentit identifikues-letërnjoftim dhe aplikacionin si dëshmi lidhur me pretendimet në apel.

Me datë 31.08.2021 PZAP ka parashtruar kërkesë për përgjigje pranë KQZ, me të cilën ka kërkuar që të njoftohet lidhur apelin e parashtruar nga pala ankuese, KQZ në përgjigjen e saj ka theksuar se lidhur apelin e parashtruar nga Isuf Qestaj, siç shihet edhe në ankesat paraprake të aplikuesve me mbiemër të njëjtë Qestaj me vendbanim në Zvicër, nga e njëjta e-mail adresë ka dërguar aplikacione për personat me mbiemrin Qestaj, që kanë vendbanim në shtetin Gjermanisë.

Si të tilla, dërgimi i aplikacioneve për regjistrim pavarësisht se është i njëjti mbiemër, e që janë dërguar nga e-mail adresa "isuf\_qestaj@outlook.com" nuk konsiderohet rreth i ngushtë familjarë, për shkak që të gjitha aplikacionet e dërguara tashmë nga ky e-mail, janë aplikacione për persona që kanë vendbanim në Zvicër dhe Gjermani, e në data bazën e aplikimit për regjistrim, rezulton se është edhe një mbiemër Qestaj, me vendbanim në Suedi, dhe se të gjitha këto aplikacione për regjistrim janë refuzuar.

Paneli, pasi që shqyrtoi dhe vlerësoj të gjitha pretendimit e apelimit, në kuptim të nenit 117 par.2 të LZP-së, gjeti se:

### **Apeli është i bazuar**

Paneli, pasi shqyrtoi shkresat e lëndës konstatoi se apeli është i bazuar pasi që parashtruesi i apelit Isuf Qestaj, ka aplikuar për regjistrim për votim jashtë Kosovës, përmes e-mail adresës personale elektronike "isuf\_qestaj@outlook.com", për të cilat i njëjti ka paraqitur dëshmi që e vërteton faktin se ka aplikuar brenda afatit ligjor, më datë 12.08.2021, dhe se aplikacionit ia kishte bashkangjitur dokumentin valid të identifikimit (letërnjoftimin e Republikës së Kosovës).

Paneli ka konstatuar se edhe pse aplikimi është bërë përmes një email-i për disa persona me mbiemër të njëjtë, dhe që kanë vendbanim të njëjtë kjo nuk e vërteton faktin se Isuf Qestaj, nuk mund të përfshihet në bazën e të dhënave të KQZ-së për tu regjistruar si votues jashtë Kosovës, sepse i njëjti i ka plotësuar kriteret të cilat kërkojnë në bazë nenit 5.1 pika a) të LZP-së ku përcaktohet: **“çdo person ka të drejtë për të votuar nëse është i regjistruar si qytetar i Kosovës në Regjistrin Qendror Civil të Kosovës”**, si dhe dispozita e nenit 3.1 të Rregullës Zgjedhore 03/2013 të KQZ-së ku përcaktohet se: **“votuesi me zotësi juridike jashtë Kosovës mund ta hedh fletëvotimin për zgjedhjet në qoftë se është regjistruar si banorë i përhershëm i Kosovës në Regjistrin Qendror civil”** dhe dispozita e nenit 3.3 të Rregullës Zgjedhore 03/2013 të KQZ-së ku përcaktohet se:

*3.3 Personi i cili ka për qëllim të hedhë votën për Votim Jashtë Kosovës...do të regjistrohet në KQZ si votues jashtë Kosovës duke dorëzuar:*

*a) formularin për Aplikim/Regjistrim për votim jashtë Kosovës, kopja e së cilës është bashkangjitur si Shtojcë II, dhe,*

*b) dëshminë e dokumentacionit të identitetit dhe që ai ose ajo i plotëson kriteret ligjore për të drejtën për të votuar në pajtim me nenin e LZP-së dhe të bashkangjiten dokumentet e fotokopjuara siç janë të renditura në Shtojcën III. të kësaj rregulle.*

Prandaj, nga arsyet e theksuara më lart si dhe duke u bazuar në dispozitat e nenit 117 par. 3, 118 par. 1, 122 par. 1 pika a) të LZP-së, si dhe nenit 11 par. 6 të Rregullës Nr.02/15 të PZAP-it, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

### **Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa**

A nr. 571/2021 më datën 02.09.2021

**Kryesuesi i Panelit**  
Adnan Konushevc



**Këshillë Juridike:** Kundër këtij vendimi është e lejuar ankesa, sipas nenit 118 par.4 të LZP-së, në Gjykatën Supreme të Kosovës, brenda njëzetekatër (24) orëve nga momenti i marrjes-pranimit të këtij vendimi.